



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:205361
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05476212

C.A.P.1217/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari individual Besnik Bislماج, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit A. C., me vendbanim në lagjen Bregu i Diellit, Aktash III, Bll..., H.../1 në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson R. P., avokat me seli në rr. “N... K.”, objekti “Li. 1” B1,nr.3 në Prishtinë, kundër debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A “KEDS”, me seli në Prishtinë, për përmbarimin e dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, CPC.nr.164/22, të datës 03.07.2023, më datë 18.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A “KEDS”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, CPC.nr.164/22, të datës 03.07.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, ka vendosur si vijon: I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i datës 18.11.2022, paraqitur nga debitori Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A, me seli në Prishtinë, dhe mbetet në fuqi Aktvendimi me shenjë CPC.nr.164/22, i datës 03.11.2022, nxjerrur nga kjo gjykatë si organ përmbarues. II. OBLIGOHET debitori Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A, që t’ia kompensojë kreditores R. Ll., shumën prej 208.00 €, në emër të shpenzimeve procedurale.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës që ankesën e debitorit ta aprovojë ndërsa Aktvendimin për Përmbarim Cpc.nr.164/2022 të datës 03.11.2022 ta anulojë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Kreditori përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur përgjigje në ankesë përmes së cilës i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të palës debitore, me propozim që ankesa e të njëjtit të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, nenit 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori A. C., përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, me datë 05.04.2022, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka parashtruar propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit përmbarimor, përkatësisht aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2959/16, të datës 13.11.2019, i plotfuqishëm me datë 13.11.2021 i vërtetuar me Aktgjykim të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2739/2020, të datës 13.12.2021. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Aktvendim për Caktimin e Përmbarimit CPC.nr.164/22, të datës 03.11.2022, me të cilin e ka lejuar pjesërisht përmbarimin, duke e pranuar si dokument përmbarimor, i cili i plotëson kushtet për ta lejuar përmbarimin.

Kundër urdhrin përmbarimor, debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim dhe atë me datë 18.11.2022, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me pretendimet se dokumenti përmbarimor mbi bazën e të cilit është iniciuar propozimi për përmbarim nuk i përmban tiparet e përmbarueshmërisë. Ka propozuar që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar ndërsa aktvendimi për përmbarim Cpc.nr.164/22, i datës 03.11.2022 të anulohet dhe të obligohet kreditori që t'i bart; shpenzimet përmbarimore në tërësi.

Me përgjigje në prapësim, kreditori ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabazuara duke theksuar se pretendimet e të njëjtit janë bërë me qëllim të zvarritjes së procedurës ngase propozimi për përmbarim është mbështetur në dokument përmbarues sipas dispozitave ligjorë të LPP-së e po ashtu edhe me revizionin e paraqitur, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev.287/2022, të datës 11.10.2022 e ka refuzuar si të pathemeltë Revizionin e debitorit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.2739, të datës 13.12.2021. Ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar. Shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit, me aktvendimin e atakuar, ka vendosur që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa aktvendimin për lejimin e përmbarimit e ka lënë në fuqi, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se në rastin konkret, propozimi për përmbarim është lejuar nga kjo gjykatë si organ përmbarues, në përputhje me Aktgjykimin C.nr.2959/16, i datës 13.11.2019, i cili ka marr formën e prerë me datë 13.12.2021, dokument ky që plotëson të gjitha kushtet ligjore për përmbarueshmeri konform nenit 27 par.1 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se: *“1. Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.”*, andaj edhe pretendimi i debitorit se dokumenti nuk përmban tipare të përmbarueshmërisë është i pabazuar, pasi që kjo gjykatë ka konstatuar se me aktgjykimin e lartëcekur në cilësinë e dokumentit përmbarimor, kreditorit i është njohur shuma e përgjithshme prej 16,149.88 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data 13.11.2019 e deri në pagesën definitive, andaj edhe propozimi për përmbarim, bashkë me dokumentin e nisur përmbarimor, janë të ligjshme dhe të përmbarueshme

Për mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 21, 22, paragrafi 1, pika 1.1, neni 23, paragrafi 1 dhe neni 27, paragrafi 1 të LPP-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449 dhe 452 të LPK-së e në ndërlidhje me nenin 17 të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, gjyqtari i Gjykatës së Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, fillimisht i shqyrtoi pretendimet ankimore të debitorit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore me rastin e marrjes së aktvendimit, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të paqëndrueshme kjo për faktin se dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike duke iu referuar edhe dispozitave ligjore përkatëse. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare e në lidhshmëri me këtë ka nxjerrë edhe aktvendimin e atakuar tani me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, të pa themelta qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankues lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit përmbarimor si në dispozitivin e nenit 21 dhe nenin 22 të LPP-së që si i tillë paraqet titulli përmbarues sipas dispozitës së nenit 22, paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, në të cilin është përcaktuar se, si dokument përmbarues është edhe *“vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese”*. Në rastin konkret titull përmbarues është aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë i plotfuqishëm me datë 13.11.2021 i vërtetuar me Aktgjykim të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2739/2020, të

datës 13.12.2021. Si dokument përmbaues në bazë të nenit 23 paragrafi 1, të LPP-së, është përcaktuar se “sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdj gjyqësore konsiderohet ujdja e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit” dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me vendim përmbaues të gjykatës siç përcaktohet me dispozita ligjore.

Duke e shqyrtuar aktvendimin e ankimuar në raport me pretendimet tjera ankimore, Gjykata e Apelit ka gjetur se të njëjtat janë të pa bazuara ngase me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se “Baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”. Në këtë rast debitori me anë të prapësimit nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të argumentonte ndonjërin nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, prandaj kjo gjykatë e vlerëson si të drejtë përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbauese “në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (b) të LPK, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.A.P.nr.1217/2023, me datë 18.03.2024

Gjyqtari
Besnik Bislimaj, d.v